# ***SYLLABUSI i Lëndës: FAIR PLAY NË SPORT (Bachelor-zgjedhore)***

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i sportit** |
| **Titulli i lëndës:** | **Fair Play në Sport** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **I –rë (Parë)** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+0** |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | **Prof. Asst. Bahri Gjinovci** |
| **Detajet kontaktuese:** | **bahri.gjinovci@uni-pr.edu** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | *Lënda Fair Play në Sport fokusohet në vlerat themelore të ndershmërisë, respektit dhe integritetit, të cilat janë thelbësore jo vetëm për sportin, por edhe për jetën e përditshme.*<br><br>*Ajo synon të zhvillojë te studentët kuptimin e drejtë të parimeve të fair play-t dhe rëndësinë e tyre në formimin personal dhe profesional.*<br><br>*Përmes analizës teorike dhe shembujve praktikë, studentët njihen me korrektësinë e lojërave sportive dhe me rolin e edukatorit në promovimin e sjelljeve etike.*<br>*Lënda inkurajon aplikimin e koncepteve të fair play-t në procesin mësimor, në institucionet shkollore dhe jashtë tyre.*<br><br>*Në këtë mënyrë, studentët përgatiten të kontribuojnë në ndërtimin e një kulture sportive të bazuar në respekt, barazi dhe përgjegjësi shoqërore* |
| **Qëllimet e lëndës:** | *Qëllimi i lëndës është të aftësojë studentët për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar në mënyrë profesionale parimet e ndershmërisë, respektit dhe korrektësisë, si bazë e edukimit sportiv dhe e sjelljes etike në jetën e përditshme.*<br><br>*Lënda synon të zhvillojë tek studentët kompetenca për të analizuar dhe promovuar rregullat e fair play-t, duke i ndihmuar ata të kuptojnë se pa drejtësi, besim dhe respekt humbet kuptimi i garës dhe dëmtohet integriteti i sportit.*<br><br>*Përmes diskutimeve, analizave dhe rasteve praktike, studentët aftësohen të identifikojnë dhe të menaxhojnë sjelljet joetike, duke promovuar vlera të ndershme në çdo mjedis sportiv.*<br><br>*Në thelb, qëllimi i lëndës është të nxisë ndërgjegjësimin për rolin e sportit si mjet edukativ, moral dhe social që bashkon njerëzit dhe forcon kulturën e respektit, solidaritetit dhe përgjegjësisë.* |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | *Studentet që me sukses plotesojne të gjitha detyrat e këtij moduli, aftesohen që te ardhmen te mesojnë së si t'i aplikojne vlerat si:*<br>*Respekti, Miqesia, Shpirti ekipor, Garimi korrekt dhe Sporti pa doping si dhe vlerat e shkrura dhe te pashkruara te barazise, integritetit, solidaritetit, tolerances, kujdesit etj* |
| | |
| | |
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | *Në realizimin e lëndës do të përdoren metoda bashkëkohore dhe të kombinuara që nxisin të menduarit kritik dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve. Kryesisht do të aplikohen:*<br><br>*Metoda verbale, përmes ligjëratave, diskutimeve dhe shpjegimeve të koncepteve teorike lidhur me etikën dhe rregullat e fair play-t.*<br><br>*Metoda e demonstrimit, ku përmes shembujve konkretë dhe situatave praktike sportive, studentët do të shohin dhe analizojnë sjelljet e drejta dhe joetike në sport.*<br><br>*Metoda interaktive**,** që përfshin debatet, punën në grupe, studimet rastore dhe reflektimet personale, me qëllim që studentët të zhvillojnë qëndrime dhe aftësi për të zbatuar parimet e fair play-t në praktikë* |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | 1. Testet I 35 pikë<br>3. Seminari (prezentimi) 15 pikë<br>4. Vijimi i rregullt 10 pikë<br>5. Testet II 40 pikë<br><br>SUKSESI: 51-60 =**6(E**), 61-70=**7(D),** 71-80=**8(C),** 81-90=**9(B),** 91–100=**10(A)** |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | *1. Fair Play në Sport , B.Ginovci*<br>*2. Fair Play: The Ethics of Sport by Robert L.Simon, Cesar R. Torres, Peter F. Hager*<br>*3. Ethics in Sport William J. Morgan (University of Southern California)*<br>*https://books.google.al/books?id=pE88DwAAQBAJ&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false* \ |

| | |
|---|---|
| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
| **Java** | **Ligjerata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | *FairPlay në Sport* |
| ***Java e dytë:*** | *Zhvillimi i Sportit modern* |
| ***Java e tretë*:** | *Çka është Fer*<br>*Kartannderkombëtare e Fair-Playt*<br>*Dhjetë urdhërime për Sportistet* |
| ***Java e katërt:*** | *Dhjetë urdhërimet për Sportistet profesional*<br>*Komeiteti nderkombëtar I fair Playi-t për të rinjë* |
| ***Java e pestë:*** | *Parimet në Sport për një lojë të ndershme*<br>*Parimet për trajner* |
| ***Java e gjashtë*:** | *Çka është Etika dhe Morali*<br>*Etika në Sport* |
| ***Java e shtatë:*** | *Mesazhet e Trajnerve për Fair Play (Lojë të ndershme )* |
| ***Java e tetë:*** | *Dhuna në Sport*<br>*Kodi i Mirësjelljës për Sportistët*<br>*Kodi i mirësjelljës për prind* |
| ***Java e nëntë:*** | *Etika Sportive e Gjyqtarëve* |
| ***Java e dhjetë:*** | *Kodi i mirësjelljes për Shiquesit* |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | *Kodi Etik i Trajnerit dhe Arsimtarit të edukimit Fizik* |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | *Kodi i mirësjelljës për Sportistet* |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | *Ndihmoni Femijët ta shijojn Sportin* |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | *Disa nga Rregullat e Fair Play-it* |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | *Vleresimi* |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: |
| --- |
| ***Objektivi I UP-se është ti zbatojë konceptet evropiane në arsimin e lartë për të mirën e ekonomisë dhe shkencës, mirëqenjës qytetare si dhe interesin për tërë shoqerinë .*** |